# DËSHMI ARKIVI

**A-458956**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Në Pogradec nga vonuan mbi 3 orë", motra e nënës shtatzënë që ndërroi jetë: Dua drejtësi! |
| ADRESA | `https://lapsi.al/ne-pogradec-nga-vonuan-mbi-3-ore-motra-e-nenes-shtatzene-qe-nderroi-jete-dua-drejtesi-i1092715` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 03:02:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 31 gusht 2026, 15:00:37 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2aa80b16cc72d1b3f87cffa84a9b85293ec27d58d75bab5ac05e6f35a3cfe524` |
| TEKSTI | `c6a5b2450d7b11355190df91c280a8d765f40025472e50daeab41735ddaf7cbf` |
| PAMJA | `c3cab0cf0771283b633bee377ba4f393655e77a99cc3f3b0b936fe6cc2fa453e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f3de5110d8911e429900b5cb5d73e75fd088d8584e38af16767fa378d960de22` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4de269ffca6a297af7c396c32fb13741f5fd12f8a3433567c0e499af34b76d0f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f3de5110d8911e429900b5cb5d73e75fd088d8584e38af16767fa378d960de22`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Në Pogradec nga vonuan mbi 3 orë", motra e nënës shtatzënë që ndërroi jetë: Dua drejtësi!

LAPSI.AL • 31 AUGUST 2026



Një ngjarje e rëndë ka tronditur Pogradecin, ku një 37-vjeçare shtatzënë, Marjana Karolina Bunaj, ka humbur jetën teksa po transportohej drejt Tiranës për ndihmë të specializuar mjekësore. Familjarët ngrenë pikëpyetje për mënyrën se si është menaxhuar situata në maternitetin e Pogradecit dhe kërkojnë zbardhjen e plotë të rrethanave.

Motra e të ndjerës, Albina Mekolli, e cila e ka shoqëruar Marjanën gjatë gjithë qëndrimit në maternitet, rrëfeu mes lotësh momentet e vështira që paraprinë humbjen e saj.

Sipas saj, gjithçka nisi rreth mesditës, kur 37-vjeçarja e telefonoi duke i thënë se kishte dhimbje të forta në bark

"Në orën 12 më merr në telefon dhe më tha: Eja se kam dhimbje të forta barku. Shkova shumë shpejt sepse jemi afër. E çova në maternitet sepse ishte shtatzënë. Mjekja roje i bëri një vizitë, një eko dhe tha se ka një gjakderdhje të brendshme", rrëfeu Albina.

Pas konstatimit të gjendjes së rënduar, familjarët u njoftuan se 37-vjeçarja duhej të transportohej drejt Tiranës. Sipas motrës, gjatë kësaj kohe u diskutua edhe mundësia e transportit me helikopter, por kjo nuk u realizua.

"Dëgjova që po thonin helikopterin, por u shprehën se nuk vjen dot sepse është natë", tregoi ajo.

Më tej, sipas dëshmisë së saj, Marjana u dërgua te reanimacioni, ndërsa familjarët pretendojnë se pati vonesa përpara nisjes me ambulancë drejt Tiranës.

"Mjekja foli me dikë dhe erdhën mjekët e reanimacionit, e dërguan atje dhe pati vonesa. Me ambulancë e nisën pas orës 4 të mëngjesit. Në Pogradec nuk iu bë asnjë ndërhyrje kirurgjikale. Në tre orë i vunë vigonë për serume dhe gjak", deklaroi Albina.

ide



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati



Gënjeshtra e rezorteve elitare
Blendi Kajsiu

MOTI TIRANA 19°C
KËMBIMI EURO 91.54

aktuale

19:34
Protesta e 112-të në Tiranë, protestuesit kërkojnë ndryshim të Kodit Zgjedhor

09:44



U ndaluan pas tensioneve në tubimin e djeshëm, lirohen 25 të ndaluarit




TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku



Ajo beson se një ndërhyrje apo transport më i shpejtë mund të kishte ndryshuar fatin e motrës së saj.

“Nëse do të ishim nisur pak më parë, do të më kishte shpëtuar motra të paktën, sepse mbase fëmija nuk do të kishte shpëtuar. Mbase nëse arrinim më herët në Tiranë do të shpëtonte”, tha ajo.

Familjarët kanë kërkuar hetim të plotë për të përcaktuar nëse vonesat kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes së 37-vjeçares dhe në humbjen e jetës së saj.

“Kërkoj drejtësi, të zbardhet e vërteta, a ndërroi jetë nga pakujdesia apo jo. Unë besoj që nëse do të kishte më shumë shpejtësi, sot do të ishte mes nesh”, u shpreh motra e Marjana Karolina Bunajt.

Sipas familjarëve, bashkëshorti i 37-vjeçares ishte larguar drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës vetëm tre ditë para ngjarjes, me synimin për të realizuar bashkimin familjar. Fëmija që Marjana priste ishte i pari për çiftin.

## Të këshilluara



### Kriza e emigracionit në Ceuta/ Italia zgjat pezullimin e Shengenit për Spanjën

Italia ka vendosur të zgjasë edhe për 15 ditë pezullimin e rregullave të Shengenit për udhëtarët që mbërrijnë nga Spanja, duke mbajtur kontrollet kufitare në portet dhe aeroportet italiane.



### Rama harron Tik Tik-un: Sigurinë në shkolla do ta ofrojnë kamerat inteligjente

Kryeministri Edi Rama ka bërë të ditur se 20 institucione arsimore në Tiranë janë pajisur me kamera inteligjente, në kuad&eu...




### Raporti i AMF për 7-mujorin: SIGAL dëmshpërbleu mbi 16 milionë euro



### Denoncimi i atletit David Nikolli: Federata nuk më dërgoi në Lojërat Mesdhetare sepse dola në protestë

Në vitet e shkuara, kemi parë shumë atletë shqiptarë të largohen nga Shqipëria dhe të përfaqësojnë shtet...



1 **Burri vret me thikë gruan teksa kujdesej për 2 nipërit, 68-vjeçari ishte arrestuar edhe më parë për dhunë në familje**



2 Historia e ndarjes territoriale që nga pavarësia



3 Prej disa ditësh, Alket Rizai shfaqet në pamjet e një vrasje brenda burgut



4 Gemini hakon tri kompani, ngrihen pikëpyetje për sigurinë e AI-së



### Kush është Bekim Sejdiu? Emri që bashkoi VV-në dhe LDK-në për Presidencën

Bekim Sejdiu ka konfirmuar se ka pranuar propozimin për të kandiduar për president të Kosovës, pasi Lëvizja Vetëvendosje dhe...



### Gazetari: Edi Rama dhe Evis Sala gënjyen publikisht për trombektominë në QSUNT

Tre ditë pasi kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Shëndetësisë, Evis Sala, njoftuan se trombektomia tashmë ofrohet si shërbim i...



## Marrëveshja në Kosovë/ Bekim Sejdiu: Jam në shërbim të Kosovës, qytetarëve dhe shtetit tonë!



### "PasqyrAlbania" e Ramës, një emër i ri për një premtim të vjetër

Pas protestave maratonë të njohura si "Revolucioni i Flamingove", kryeministri Rama premton një platformë të re komunikimi me qytetarët, por ekspertët paralajmërojnë se ky është një version i ri i një ideje të vjetër që nuk i zgjidh problemet e qeverisjes.



### Kush është Bekim Sejdiu, presidenti i dakortësuar i Kosovës

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, kanë arritur marrëveshje për emrin e kandi...



### Dosja "Balluku"/ Igli Tare del nga SPAK pas 3 orësh

Igli Tare është paraqitur sërish në SPAK, ku ka qëndruar për rreth tre orë, në kuadër të hetimeve që lid...

## Me sytë katër










22:48

## PAMJET/ 12 vite më parë Thaçi qeshte kur Albin Kurti i kërkoi të mos e votonte Specialen

Në prill të vitit 2014, kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, asokohe deputet i Parlamentit, paralajmëroi Hashim Thaçin pë...



PAMJET/ Shqiptarët "pushtojnë" gjykatën e Hagës para vendimit për krerët e UÇK-së

21:25



"O hajdut, o hajdut...", shihni si iu ikën protestuesve Taulant Balla (VIDEO)

20:44



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

20:36



Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43

# SPORT

Të tjerë artikuj



20:46

Dinamo thyen Laçin e mbetur me 10 lojtarë: suksesi i katërt radhazi për Dajën, protestojnë kurbinasit



20:06

Roma e frikshme vetëm për një pjesë: Inter rikuperon dy gola e del me pikë nga Olimpico



18:19

Arsenal, çfarë shembje në fushën e Brighton! Makth për Tottenham, De Zerbi sërish humbet



17:59

Plasin polemikat në fund, VAR akordon penalltin në minutën e 96': Vora e tërbuar, Skënderbeu merr pikën



12:28

"Nuk është derë që mbyllet, fola me ata": Maran shpjegon lënien jashtë të Brojës e Bajramit e zbulon pse riktheu Berishën



11:28

Kush janë Kerjota e Sina, dy debutuesit e thirrur në Kombëtare nga Maran: habit mbrojtësi 19 vjeçar




11:09

Jashtë Broja, Maran kthen të "syrgjynosurin" nga Sylvinho: debutues e befasi në 29 zgjedhjet për Nations League

# PAPARAZZI





"Më pëlqejnë muzikantët": Dakota Johnson nxit aludimet për MGK

21:45



Frikë në familjen Kardashian/ Kim zbulon problemin shëndetësor

20:07







Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.